

**VENDIM**  
**Nr. 104/2017**

**PËR KËRKESËN E PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS  
SË PARË PËR KRIME TË RËNDA, TIRANË, “PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT  
PËR ARRESTIMIN OSE HEQJEN E LIRISË, TË KONTROLLIT PERSONAL DHE TË  
BANESËS TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, ZOTIT SAIMIR TAHIRI”**

Në mbështetje të nenit 73, pikat 2 dhe 4, të Kushtetutës, të nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 118, pikat 4 dhe 5, të Rregullores së Kuvendit, me rekomandim të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për:

- Dhënien e autorizimit për kontrollin personal dhe të banesës për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Saimir Tahiri.

- Dhënien e autorizimit për ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, ndalimin dhe detyrimin për të qëndruar në një vend të caktuar, si masë shtrënguese të heqjes së lirisë në kuptim të shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 232, të Kodit të Procedurës Penale.

II. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për dhënien e autorizimit për masën e arrestit në burg ose në shtëpi për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Saimir Tahiri, në kuptim të shkronjave “d” dhe “dh”, të nenit 232, të Kodit të Procedurës Penale.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 25.10.2017